

VENDIM
Nr.20, datë 11.1.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.839, DATË 5.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË PAGUAR DHE KRIJIMIN E KUSHTEVE LEHTËSUESE PËR
NDËRTIMIN E BURIMEVE TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, ME FUQI TË
INSTALUAR JO MË PAK SE 5 MW”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.8987, datë 24.12.2002 “Për krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.839, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime.

1. Në pikën 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në paragrafin e parë, fjalët “... në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ...” zëvendësohen me “..., brenda datës 10 të muajit pasardhës, në drejtorinë rajonale ku është i regjistruar ...”.

b) Në shkronjën “a”, fjalët “... për një periudhë tremujore ...” zëvendësohen me “... për një periudhë njëmujore ...”.

2. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Rimbursimi i akcizës për lëndën djegëse të konsumuar, të llogaritur sipas formulës, bëhet në mënyrë automatike nga drejtoria rajonale e tatimeve ku është i regjistruar subjekti, nga llogaria e veçantë buxhetore, e krijuar nga kjo drejtori për këtë qëllim.

12.1. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar në rast se subjekti, që ka paraqitur kërkesën për rimbursim, plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;

b) Është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;

c) Nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore apo penalitete të papaguara;

ç) Ka deklaram të rregullt të TVSH-së dhe s’ka penalizime.

12.2. Kërkesa e paraqitur nga subjekti, që plotëson kriteret e sipërpërmendura për rimbursimin automatik, vlerësohet dhe për të procedohet, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore. Kërkuesit për rimbursim mund të kontaktohen për të sqaruar problemet, por atyre nuk do t’u kërkohej dokumente shtesë, përveç dokumenteve të përcaktuara në këtë pikë. Kërkesat, që nuk plotësojnë kushtet, do të dërgohen për kontroll dhe, në këtë rast, kërkuesit mund t’i kërkohej të paraqesë dokumente shtesë.

12.3. Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të parë, organi tatimor duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike pas miratimit të shumës për t’u rimbursuar.

12.4. Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

12.5. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën kohore të paraqitjes së kërkesave.

12.6. Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar, si dhe mbi të zbatohen penalitetet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.

3. Në pikën 13, fjalët “... jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë ...” zëvendësohen me “... jo më vonë se 5 ditë ...”.

II. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha